

NARRATIVE AND COMMENTATIVE TENSES IN ALBANIAN LANGUAGE

Agnesa Hasimja – Pasha

University of Prishtina “Hasan Prishtina”, Kosovo, agnesahasimja@uni-pr.edu

Abstract: Main part of this research is the treatment of four tenses of the indicative mood: Past simple tense, Present Perfect tense, Pluperfect tense and Past perfect tense in various types of texts in Albanian language.

In the Grammar of Albanian language I (2002), the past simple tense indicates an action completed at a certain moment of the past. It is used in an overall sense of time and in some circumstances also in the sense of future. Whereas, the Present Perfect tense of the indicative mood also indicates a completed action, but which has not cut the liaisons with the moment of speech. Through this tense, along with the completion of the action, the speaker points out also its consequences at the moment of speech. Also there it is said that the Present Perfect tense is sometimes used also in the sense of the Past simple tense and vice-versa.

On the other hand, the other two tenses, the Pluperfect tense and Past perfect tense, the Grammar treats as synonymous. According to it, the Pluperfect tense indicates a completed action before a certain moment of the past. In the Grammar of the Albanian language (2002) it is said that this completed action can be related to a certain moment of the past through consequences or continuation until that moment. Also for the Past perfect tense the Grammar says that it indicates an action completed before a certain moment of the past.

However, as often discussed in scientific conferences, the studies of the Albanian have mainly been based on the analysis of the tenses of verbs on an extra-textual ground, more specifically they have dealt only with the analysis of their meaning and function within a sentence or a compound sentence (Rugova, 2010). Therefore, seen from the textual aspect, respectively attitude speaker and the viewpoint, the aim that through this paper to present eventual differences and functional similarities between the Present Perfect tense and the Past simple tense, as well as the Pluperfect and the Past perfect tense of the indicative mood in Albanian language. Part of the corpus of this research will be some literary and nonliterary texts.

Keywords: Past simple tense, Present Perfect tense, Pluperfect tense, Past Perfect tense.

KOHËT RRËFIMORE DHE KOHËT KOMENTATIVE NË GJUHËN SHQIPE

Agnesa Hasimja – Pasha

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë, agnesahasimja@uni-pr.edu

Abstrakt: Pjesë kryesore e këtij hulumtimi është trajtimi i katër kohëve të mënyrës dëftore: kohës së kryer të thjeshtë, kohës së kryer, më se të kryer dhe kohës së kryer të tejkshuar në tipa të ndryshëm të teksteve në gjuhën shqipe.

Në Gramatikën e gjuhës shqipe I (2002), koha e kryer e thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Ajo përdoret me kuptim mbarëkohor e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes. Ndërsa, koha e kryer e mënyrës dëftore tregon po ashtu një veprim të përfunduar, por që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërit. Nëpërmjet kësaj kohe, krahas përfundimit të veprimit, folësi vë në dukje edhe pasojat e tij në çastin e ligjërit. Gjithashtu aty thuhet se koha e kryer përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin e kohës së kryer të thjeshtë dhe anasjelltas.

Ndërkaq, dy kohët e tjera, më se të kryerën dhe të kryerën e tejkshuar Gramatika i trajton si sinonimike. Sipas saj më se e kryera tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Në Gramatikën e shqipes (2002) thuhet se ky veprim i përfunduar mund të lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose vijimit gjer në atë çast. Gjithashtu edhe për kohën e kryer të tejkshuar Gramatika thotë se tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

Mirëpo, siç është diskutuar shpeshherë në konferencat shkencore, studimet e shqipes janë mbështetur kryesisht në analizën e kohëve të foljeve në një rrafsh atekstual (jashhtëkstor), më saktësisht janë marrë vetëm me analizën e kuptimit dhe të funksionit të tyre brenda fjalisë a periudhës (Rugova, 2010).

Prandaj, shikuar nga aspekti tekstor, përkatësisht qëndrimi folës dhe këndvështrimi, synojmë që përmes këtij punimi të paraqesim dallimet eventuale dhe ngjashmëritë funksionale midis kohës së kryer dhe kohës së kryer të thjeshtë, si dhe kohës më se të kryer dhe kohës së kryer të tejkshuar të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe. Pjesë e korpusit të këtij hulumtimi do të jenë disa tekste letrare dhe joletrare.

Fjalët kyçe: koha e kryer e thjeshtë, koha e kryer, koha më se e kryer, koha e kryer e tejkshuar

1. HYRJE

Në Gramatikën e gjuhës shqipe I (2002) koha e kryer e thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Ajo përdoret me kuptim mbarëkohor e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes. Kjo kohë tregon edhe fillimin e një pune a të një mënyre së qeni me anë të atyre foljeve që kanë idenë e aspektivitetit, pikërisht siç bëjnë aoristat inkoativë (aspekti i fillimit të veprimit) grekë, p.sh., *Me të vajtur Skënderbeu në Lesh, ra i sëmurë* (Cipo, 2015). Ndërsa, koha e kryer e mënyrës dëftore tregon po ashtu një veprim të përfunduar, por që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit. Nëpërmjet kësaj kohe, krahas përfundimit të veprimit, folësi vë në dukje edhe pasojat e tij në çastin e ligjërimit. Gjithashtu, aty thuhet se koha e kryer përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin e kohës së kryer të thjeshtë dhe anasjelltas. Ndërkaq, dy kohët e tjera, më se të kryerën dhe të kryerën e tejskUAR Gramatika i trajton si sinonimike. Sipas saj më se e kryera tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Sipas Gramatikës së shqipes (2002) ky veprim i përfunduar mund të lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose vijimit gjer në atë çast. Gjithashtu edhe për kohën e kryer të tejskUAR Gramatika thotë se tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Një shpjegim të ngjashëm e gjejmë edhe te Shaban Demiraj (2015) dhe Kolec Topalli (2010). Ndërsa, Fiedler-i dhe Bucholz-i theksojnë se koha e kryer e tejskUAR për sa i përket kohëshmërisë është vetëm një kohë e parakohshme (a), ndërsa më se e kryera mund të ndodhë në funksionin paskohor (b): a) *Si pat vënë gjithçka në rregull, u nis për në punë.*; b) *Stavri pushoi një copë herë, sikur donte të sillte në hatër, ç'i kishte ndodhur më tej* (Buchholz-Fiedler, 1987). Gjithashtu, Cipo (2015) shton se puna që tregon koha më se e kryer është një punë e bërë më parë nga një tjetër, p.sh. *Ja që e kish(te) bërë i gjori atë gabim, po s'e rrëfente dot se s'kish(te) guxim.*

2. SFONDI TEORIK

Ndër studiuesit e parë të huaj, i cili propozoi që për përshkrimin e kohëve për bazë të merrej teksti, është gjermani Weinrich. Ndërkaq, rreth viteve '70, studiuesi Ismajli e pa nevojën e studimit përtej fjalisë, duke analizuar tekstin si njësinë më të madhe edhe në gjuhën shqipe. Në disa nga veprat e tij, si: “Shumësia e tekstit” (1977) etj., pos tjerash, trajton edhe kohët e foljeve në rrafshin tekstor, duke përfshirë qëndrimin dhe pikëvështrimin e folësit. Nëpërmjet hulumtimeve të tij, ai mëton t'i sjellë rezultatet e përdorimeve të foljeve nëpër lloje të ndryshme të teksteve, duke bërë edhe klasifikimin e tyre në kohë rrëfyese dhe përfolëse. Këta janë termat që i propozon vetë Ismajli në vend të emërtimeve të tjera: “narrative” dhe “komentative”, si terma të Benvenistit të shfrytëzuar nga Weinrichu. Prandaj, shikuar nga aspekti tekstor, përkatësisht qëndrimi folës dhe këndvështrimi, synojmë që përmes këtij punimi të paraqesim dallimet eventuale dhe ngjashmëritë funksionale midis kohës së kryer dhe kohës së kryer të thjeshtë, si dhe kohës më se të kryer dhe kohës së kryer të tejskUAR të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe.

Gjuhëtari gjerman Weinrich e bëri analizën e formave kohore në tekst. Ai trajtoi qëndrimin folës dhe këndvështrimin. Ndarja e parë bën dallimin ndërmjet botës së “diskutuar” dhe të “rrëfyer”, ndërsa ndarja e dytë bën ndarjen e planit të parë dhe të dytë. Ndarja e parë më tutje sqaron marrëdhëniet ndërmjet dërguesit (rrëfyesit) dhe subjektit të dërguar prej tij (rrëfimit). Kjo marrëdhënie mund të jetë më intime, më e drejtpërdrejtë dhe mund të jetë më e veçuar: më e përfolur. Në rastin e parë, dërguesi (e me të edhe marrësi) është i ndërlidhur drejtpërdrejt në ngjarjet e rrëfimit (kohë rrëfyese). Në rastin e dytë, dërguesi zgjedh të përfolurit e asaj që ka ndodhur, pra vë një distancë më të madhe mes vetes dhe rrëfimit (kohë të komentit ose të përfoljes) (te Rugova, 2015). Sipas Weinrichut, përkundër kohëve të rrëfimit, kohët e komentit i sjellin dëgjuesit ose lexuesit një qëndrim të tendosur të pranimit dhe kundërvënien në mes të këtyre dy grupeve, të grupit të kohëve të botës së komentit dhe të rrëfimit, ai i shënon me konceptin e lartpërmendur “qëndrim folës”. Weinrichu paraqet edhe dy veçori të tjera të sistemit kohor: perspektivën folëse dhe reliefizimin. Sipas perspektivës folëse kohët e të dy grupeve (komentit dhe rrëfimit) paraqesin raportin në mes të kohës së tekstit (trungu i një teksti të folur ose të shkruar në rrjedhën e tij) dhe kohës së aktit. Parainformatat dhe pasinformatat shprijnë tek përcaktimi i kohës së tekstit. Që të dyja këto informata të mëparshme dhe të mëvonshme shprehin raportin në mes të kohës së tekstit dhe kohës së aktit. Sipas reliefizimit të tekstit, Weinrichu (2001) dallon kohët të cilat japin planin e parë dhe kohët të cilat e japin prapavijën (sfondin) (Rexhepi, 2012). Koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejskUAR janë kohë të prapavijës. Duke u bazuar në kriterin e parë, ai kohët e foljeve të një gjuhe i ndan në kohë komentative dhe në kohë narrative. Sipas kësaj ndarjeje koha e kryer dhe më se e kryer bëjnë pjesë në grupin e parë, ndërsa koha e kryer e thjeshtë dhe koha e kryer e tejskUAR në grupin e dytë. Po ashtu, Comrie (2000) thotë se është e mundur që dallimet e dy kohëve të foljes të kenë më shumë se një tipar dallues dhe të ketë interpretime të caktuara që varen nga konteksti (dhe/ose konteksti)

Camaj ishte i pari që foli për dallimet në mes të kohës më se të kryer dhe të kohës së kryer të tejskUAR në gjuhën shqipe, duke i ballafaquar këto me dallimet aspektuale e kryer e thjeshtë karshi të së pakryerës. Lidhur me studime të tilla, më vonë u morën edhe studiues, si: Kelmendi, Tahiri, Rugova. Kohët e foljeve, si shprehëse të gjuhës së drejtpërdrejtë dhe të gjuhës së rrëfyer. Ai i dallon shkoqur kohët e mënyrës dëftore, duke i klasifikuar kohën e kryer dhe më se të kryer si kohë të komentit, ndërsa kohën e kryer të thjeshtë dhe kohën e kryer të tejskUAR si kohë

narrative. Në bazë të studimeve të tij, Rugova (2015) thotë se ato nuk mund ta zëvendësojë njëra-tjetrën. Për ta ilustruar këtë ai jep këta shembuj:

- A. E mban mend kur të pata dhënë një lule për 8 Mars?
- B. E mban mend kur të kisha dhënë një lule për 8 Mars?*
- C. Ai tha se ka mbetur diçka atje.
- D. Ai tha se mbeti diçka atje. *
- E. Presidenti i Shqipërisë ka arritur të mërkurën në Kosovë.
- F. Presidenti i Shqipërisë arriti të mërkurën në Kosovë.

Shembulli në fjalinë B nuk është i mundur në gjuhën shqipe. Rrjedhimisht, nuk mund të jetë sinonimike me kohën e kryer të tejkshuar, e cila gjithashtu nuk mund të përdoret në rrethana përfoljeje. Prandaj, këto dy kohë krijojnë kundërvënien me njëra-tjetrën. Tipari dallues mund të vërehet te konceptet e Weinrichut për botën e rrëfyer dhe të përfolur. Në rastin e parë bëhet fjalë për një përvojë të drejtpërdrejtë, që i përfshin të dy pjesëmarrësit e komunikimit, dhe si e tillë, ajo nuk përfillet. Individit nuk mund ta përfilasë përvojën e përbashkët të përjetuar. Pra, e kryera e tejkshuar nuk përdoret në rastet e parafrazimit, meqë në këtë rast më se e kryera vjen në shprehje. Në rastet e evokimit personal kur dërguesi është pjesëmarrës, koha e kryer e tejkshuar gjen përdorim. Kjo sjell në pah që më se e kryera është kohë komentuese, ndërsa e kryera e tejkshuar kohë narrative. Diçka tjetër që i dallon kohët komentative dhe narrative në shqipen është edhe kategoria e aspektit. Aspekti, sipas DeCapua (2018) i referohet mënyrës sesi anglishtja tregon tipare të përkohshme siç janë kohëzgjatja, frekuenca dhe përfundimi. Dallimi i dy kohëve në fjalitë C dhe D është aspekti. Por, ky nuk është dallimi i vetëm. Këto kohë, e kryera dhe e kryera e thjeshtë dallojnë edhe për nga qëndrimi folës. E para është kohë e të përfolurit, ndërsa e dyta është kohë e rrëfimit. Edhe shembujt E dhe F e shprehin dallimin. Shembulli F tregon se folësi e tregon ngjarjen si rrëfim të vetin, si dëshmitar i drejtpërdrejtë i asaj që paraqitet në tekstin e komunikuar. Shembulli E ndërkaq vë distancë, nuk e paraqet rrëfimitarin si dëshmitar të drejtpërdrejtë, por si përfolës i një komunikimi të mëpashëm, dhe si i tillë është njëfarë ligjërate e zhdrejtë e lirë, ku pjesa lajmuese nuk është e paraqitur, por është e nënkuptuar, dhe e shenjuar nga kohët e foljes.

3. SFONDI METODOLOGJIK

Duke qenë se gramatikat tradicionale të shqipes nuk i trajtojnë kohët e foljeve në rrafshin tekstor, ato shpeshherë edhe nuk i diferencojnë shkoqur. Prandaj, interesi ynë është që, duke i studiuar kohët e foljeve në një rrafsh tjetër që e tejkalon fjalinë, të bëjmë dallimin mes tyre dhe të shohim se:

- 1) a mund ta zëvendësojë koha e kryer kohën e kryer të thjeshtë dhe anasjelltas;
- 2) a janë sinonimike koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejkshuar;
- 3) a varet përdorimi i tyre nga qëndrimi folës;
- 4) çka paraqet përdorimi i njërës formë kohore kundruall tjetrës;
- 5) a dallohet shpeshësia e përdorimit të tyre varësisht nga tipi i tekstit;
- 6) a dallohet më se e kryera nga e kryera e tejkshuar edhe nga kategoria e aspektit;
- 7) çiftet e kohëve që kemi për studim, a dallohen edhe në përdorimet e tyre në ligjëratë të drejtë dhe ligjëratë të zhdrejtë.

Hulumtimi përmes analizës sasiore dhe cilësore të kohëve rrëfyese dhe përfolëse do të realizohet nëpërmjet një korpusi që do të përfshijë grupin letrar e joletar, si dhe disa tipa tekstesh: rrëfyese, argumentuese, përshkruese dhe udhëzues. Metoda teorike do të përdoret në pjesën teorike të studimit tonë, ndërsa ku më shumë e ku më pak, në sfondin teorik dhe në pjesën e hulumtimit do të shfrytëzohen metodat e ndryshme: përshkruese, analitike, krahasimtare dhe statistikore. Korpusi ynë i hulumtimit përfshin romanin “Hija” të Ismail Kadaresë, përrallën “Mbreti me zanat”, gazetën e përditshme kosovare “Koha Ditore”, si dhe Ligjin e Punës në Kosovë. Përzgjedhja ka qenë e tillë për të parë se si kohët e foljeve të synuara për hulumtim realizohen në këto tekste.

4. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Në tekstet e analizuar, në romanin “Hija” (rreth 20000 fjalë), koha e kryer është përdorur 18%, koha e kryer e thjeshtë 32%, koha më se e kryer 44%, ndërsa koha e kryer e tejkshuar ka gjetur përdorim 6%.

Në gazetën “Koha Ditore”, koha e kryer është përdorur 61%, koha e kryer e thjeshtë 8%, 30% është përdorur koha më se e kryer, ndërsa koha e kryer e tejkshuar 1%.

Në Ligjin e Punës e Kosovës, prej katër kohëve që kemi për hulumtim, në disa raste të rralla, koha e kryer gjen zbatim (4 herë), ndërsa kohët e tjera nuk përdoren, ngase në këtë tekst dominon koha e tashme e mënyrës dëftore dhe lidhore.

Në përrallën “Mbreti dhe zanat” koha e kryer është përdorur 6%, koha e kryer e thjeshtë në këtë tekst është përdorur më së shpeshti 73%, koha më se e kryer gjen zbatim 21%, ndërsa koha e kryer e tejkshuar nuk është përdorur asnjëherë.

Nga përqindja që kemi nxjerrë për përdorimin e kohëve narrative dhe komentative të foljeve në këto tekste letrare dhe joletrare, vihet re se përdorimi i tyre është i ndryshëm. Një tip i caktuar teksti, si dhe qëndrimi i folësit kushtëzojnë përdorimin e njërës trajtë kohore, kundruall tjetrës.

5. PËRFUNDIMI

Pas analizës së kohëve të foljes në tekste të ndryshme që kanë qenë pjesë e hulumtimit tonë, kemi ardhur në disa përfundime, të cilat po i rendisim më poshtë:

- përdorimi i kohëve të foljeve përcaktohet nga zgjedhja e një kategorie të caktuar tekstore.;
- përdorimi i tyre mund të përcaktohet edhe në bazë të këndvështrimit folës në kuadër të ligjërimit të shkruar a të folur;
- analizuar në rrafshin tekstor koha e kryer, si kohë përfolëse, nuk mund ta zëvendësojë kohën e kryer të thjeshtë (kohë rrëfyese);
- dy kohët relative (më se e kryera dhe e kryera e tejkshuar) nuk janë sinonimike mes vete, më se e kryera nuk mund të përdoret në një kontekst në të cilin kanë të pranishëm të dy bashkëfolësit;
- në tipa të ndryshëm të teksteve, përdorimi i kohëve narrative dhe komentative të foljes ndryshon;
- në tekstin udhëzues, nuk ka përdorim të kohës së kryer të thjeshtë, kohës më se të kryer dhe kohës se kryer të tejkshuar;
- në gazetë kanë përdorim dominues kohët përfolëse kundruall kohëve rrëfyese, çka jep të nënkuptojë që gazeta shpreh qëndrime objektive lidhur me lajmet e kumtuara;
- përdoret e kryera dhe më se e kryera atëherë kur gazetari flet për një ngjarje që e ka përfunduar në të shkuarën dhe atë e tregon në bazë të dëshmimeve që i ka mbledhur në mënyra të ndryshme, qoftë ajo përmes njerëzve, përmes medias, verbale ose të shkruar etj.;
- përdoret e kryera e thjeshtë dhe e kryera e tejkshuar kur gazetari shpreh qëndrimin folës të tij, duke u bërë vetë pjesë e rrëfimit të drejtpërdrejtë;
- përralla rrëfohen nëpërmjet një narratori, i cili zakonisht konsiderohet i gjithëdijshëm, i cili a priori i përket botës së rrëfyer. Mirëpo, kur kalon në planin e dytë në të shkuarën, ai i interpreton veprimet e të tjerëve, duke kaluar në botën e komentit nga ajo e rrëfimit dhe kështu kalon nga koha e rrëfimit (e kryer e thjeshtë dhe e pakryer) në të kryerën e komentit (më se e kryera);
- kohët relative ndër vete i kundërvihen njëra-tjetrës nga aspekti i pakryer. Derisa koha më se e kryer karakterizohet nga aspekti i papërfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës, koha e kryer e tejkshuar karakterizohet nga aspekti i përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

BIBLIOGRAFIA

- Cipo, K. (2015). Gramatikë e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Comrie, B. (2000). Tense. Cambridge: Cambridge University Press.
- DeCapua, A. (2018). Grammar for Teachers. A Guide to American English for Native and Non-Native Speakers Second Edition. Springer. New York University. New York.
- Demiraj, Sh. (2015). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH
- Floqi S. et al. (1991). Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe. Sintaksa e periudhës. Prishtinë: ETMM.
- Gramatika e gjuhës shqipe I (2002). Tiranë: ASHSH.
- Ismajli, R. (1980). Shumësia e tekstit. Prishtinë: Rilindja.
- Rugova, B. (2009). Gjuha e gazetave. Prishtinë: Koha.
- Rugova, B. – Rugova, B. (2015). Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe. Prishtinë: Trembelat.
- Rugova, B. (2012). Past tenses of Indicative in Albanian in Different Text Categories, në Poznac Balkany, Torun: Zaklad Językow Slowianskich i Balkanistyki UMK.
- Topalli, T. (2011). Gjuhësi teksti. Shkodër: Instituti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Topalli, K. (2010). Sistemi foljor i gjuhës shqipe. Tiranë: Plejad.
- Werlich, E. (1983). A Text Grammar of English. Stuttgart: Quelle&Meyer.
- Weinrich, H. (2001). Tempus - Besprochene und erzählte. München: Welt.